

Titulli i projektit

Përmirësimi i planifikimit të shërbimit publik të transportit (Bashkia Klos)

Tipi i projektit

Shërbimet Publike

Vendndodhja e projektit

Klos, Suç, Xibër, Gurrë

Buxheti i paravlerësuar

0 lekë

Përshkrimi dhe analiza e problemit/eve


Në situatën e re të dalë nga shkrija dhe bashkimi i njësjive të qeverisjes lokale në njësi më të mëdha, ofrimi i shërbimeve publike efektive pritet të jetë një prej rrjedhojave bazë të synuara. Shërbimi i transportit publik dhe mirëmbajtjes së rrugëve është i lidhur me njësinë lokale përgjegjëse për mirëmbajtjen e rrugëve lokale dhe nxjerrjen e lejeve për transport publik. Rritja e cilësisë së shërbimit publik të transportit varet nga rregullimi i aktivitetit të transportit publik nëpërmjet një sistemi efektiv lejesh, si dhe aftësia e njësisë së qeverisjes vendore për të gjeneruar mjaftueshmërisht të ardhura për të përmirësuar infrastrukturën rrugore.

Qëllimi/et specifik të projektit

Përmirësimi i aftësive të planifikimit të transportit publik dhe investimeve në infrastrukturë, si parakusht për të përmirësuar cilësinë e transportit publik në Bashkinë Klos.

Rezultatet e pritshme dhe treguesit

- Inventarizimi i rrugëve lokale të Bashkisë Klos dhe njohja e kushteve të tyre teknike (kategoritë dhe gjatësia, ashpërsia dhe kushtet teknike, volumi i trafikut dhe lloji i automjeteve, banorët që kanë akses);
- Instalimi i modelit të planifikimit rrugor në Excel sipas modelit të thjeshtuar të Bankës Botërore, për të përcaktuar koston e transportit dhe planifikimin e investimeve (përcaktimi i parametrevë të modelit dhe përlogaritja e kostove të tipeve të ndryshme të transportit publik sipas gjendjes së rrugës, planifikimi i investimeve dhe mirëmbajtjes së rrugëve si pjesë e buxheteve afatshkurtra dhe afatgjata)
- Vendosja e licensave unike dhe të kombinuara për transportin publik në Bashkinë Klos (licensa e publikuar dhe e përfshirë në paketën fiskale të miratuar nga Bashkia Klos).
- Rritja e nivelit të arkëtimit nga njësjia e shërbimit dhe ulja e nivelit të informalitetit në sektor (arkëtimet nga shitja e licensave dhe volumi i automjeteve që ushtrjnë aktivitetin në mënyrë informale).
- Investimet të reja për të përmirësuar infrastrukturën lokale të Bashkisë Klos (plane dhe zbatimi i projekteve të investimit nga Bashkia Klos).



Aktivitetet e projektit

- Inventari i rrugëve, trafikut dhe automjeteve.
- Instalimi i Software dhe Modullit të planifikimit sipas versionit të thjeshtuar dhe falas të BB.
- Përkthimi i Modullit dhe trajnimi i përdoruesve të modullit
- Përlogaritja e licensave të reja për Bashkinë Klos dhe shitja e tyre.
- Planet e reja të investimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore në buxhetet afatshkurtra dhe afatmesme të Bashkisë Klos.

Maturimi i projektit

Nuk ka asnjë modul dhe program të instaluar në nivel bashkie për momentin. Nga ana tjetër moduli është falas. Përkthimi dhe instalimi i tij mund të bëhet direkt nga punonjësit e bashkisë.

Burimet e financimit dhe partnerët në zbatim

Burimet e Financimit:

- Transferata e Pakushtëzuar
- Të ardhurat e veta nga licenca e transportit

Partnerët:

- Bashkia Klos

Kostot e projektit

Inventari i rrugëve, trafikut dhe automjeteve. 0

Instalimi i Software dhe Modullit të planifikimit sipas versionit të thjeshtuar dhe falas të BB.0

Përkthimi i Modullit dhe trajnimi i përdoruesve të Modullit 0

Përlogaritja e licensave të reja për Bashkinë Klos dhe shitja e tyre 0

Planet e reja të investimit dhe mirëmbajtjes së infrastrukturës rrugore në buxhetet afatshkurtra dhe afatmesme të Bashkisë Klos. 0